[Shqiptarja.com]

E martë 27 Gusht 2024 - Përditësimi i fundit 10:33

Kërko

LIVE Shqiptarja.tv

HOME EDICIONET LOKALE KRONIKË POLITIKË SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË EDITORIAL OPINION

TË FUNDIT SOCIALE DREJTËSUNË SPECIALE LIFESTYLE VIP & SPEKTAKËL RECETA HOROSKOPI DOSJE FOTOGALERI VIDEOGALERI PRKË E ZEZË SONDAZHE

POP 5

Gjendet makina e djegur e 3 autorëve! Pistë hetimi hakmarrja dhe prishja e pazareve të drogës (EMRI)

1 Vuajtje! Shoferi mezi me vjedhë ka fjalë me ngjyrë shumë me fajtorë shumë me vjedhë Shqipërinë me keqkon 2 persona (VIDEO)

2 Mbaka e zbulur vetë, ja kush është arsyeja e mbylljes dhe si mashtroheshim ai saj me Elin

3 Kush është njeriu që shoqëronte Panos Papadopulos dje dhe sot? Dëshmitarët e vërtetë flasin! Telegrafi e pranoja pak takimi me Putin?

4 Kërc shenja do të jetë me me fat në shtator

5 Nëna dhe motra e Marsel Çanës vënë në dyshim ndërkombëtarë Shqiptarja: Zonja ime asnë dyer

Kronikë

Atentat i dështuar në Berat, 46-vjeçari qëllohet me kallash teksa lëvizte me mjet! Gjendet makina e djegur e 3 autorëve! Pistë hetimi hakmarrja dhe prishja e pazareve të drogës (EMRI)

Një 46-vjeçar nga berati mundi t'i shpëtojë një atentati me kallashnikov nga 3 persona, të cilët pak momente më vonë dogjën makinën bashkë me armën në fshatin Kozare. Shënjestër ishte Altin Halili ish-i dënuar për vrasje, ndërsa pistë dyshohet hakmarrja ose prishja e pazareve të drogës në Itali.

- VIDEO/ Mjeti i autorëve i shkrumbuar nga flakët
- I shpëtoi atentatit sot në Dushnik të Beratit, kush është Altin Halili? I dënuar për vrasje, në 2010 u lirua nga burgu

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Qendrimet

Sh.COM Redaksia
26 Gusht, 17:26 | **Përditësimi: 26 Gusht, 22:19**

Share

A A

BERAT- Një 46-vjeçar i ka shpëtuar mrekullisht një atentati të organizuar ndaj tij në fshatin Dushnik në Berat. Altin Halili ka qenë duke lëvizur me mjet pranë një shkolle private, kur 3 persona kanë qëlluar ndaj tij me breshëri plumbash. 46-vjeçari me precedent të mëparshëm penal ka arritur që t'i shpëtojë atentatit që ishte planifikuar për eliminimin e tij.

Ngjarja ka ndodhur meth orës 16.10, në rrugën e fshatit Dushnik. Autorët e kanë zënë në pritë 46-vjeçarin dhe kanë hapur zjarr ndaj tij, por pa ia arritur qëllimit për ta vrarë. Më pas ata janë larguar nga vendi i ngjarjes në drejtim të fshatit Kozare, aty ku është gjetur edhe mjeti i djegur. Report Tv dhe Shqiptarja.com siguruan foto të mjetit të shkrumbuar të autorëve, Hunday Tuskon, brenda të cilit është gjetur edhe një kallashnikov i djegur.

Halili nuk është një emër i panjohur për autoritetet e drejtësisë. 46-vjeçari ka qenë i dënuar për vrasjen e Sokol Kaloshit në fshatin Rremas të Lushnjës. Halili ka vuajtur 14 vite burg për vrasjen dhe është liruar në vitin 2010 dhe më pas u largua për disa vite drejt Italisë. Burime për gazetaren e Report Tv, Mimoza Sinanaj bëjnë me dije se po hetohet në ky pista, në atë të hakamarrjes për vrasjen e Kaloshit dhe në atë të larjes së hesapeve, për pazaret e prishura të drogës në sfestin italian.

LEXO EDHE:
Berat/ Zjarr në fshatin Osmënzezë, dyshohet i qëllimshëm! Digjen sipërfaqe me shkurre, ullinj dhe bajame

> *"Rreth orës 16.10, në rrugën e fshatit Dushnik, është qëlluar me armë zjarri në drejtim të automjetit që drejtohej nga shtetasi Altin Halili 46 vjeç, banues në Berat, person me precedent të mëparshëm kriminal. Nga të shtënat nuk ka persona të lënduar. Menjëherë në vendngjarje kanë shkuar shërbimet e Komisariatit të Policisë Berat, Forcat Operacionale dhe ato Shqiponja të DVP Berat dhe drejtuesit e Drejtorisë Vendore të Policisë Berat.*
>
> *Shërbimet e Policisë janë vënë në ndjekje të autorëve dhe gjatë kontrollit të zonës në fshatin Kozare kanë gjetur një automjet që po digjej që dyshohet se mund të jetë i autorëve. Nga veprimet e shpejta dyshohet se autorët janë nga qarku Fier dhe për këtë janë angazhuar në veprimeve operacionale dhe shërbimet e Drejtorisë Vendore të Policisë Fier dhe Komisariatetve në varësi të saj", njofton policia.*

Në vendngjarje shkuan shërbimet e Komisariatit të Policisë Berat, Forcat Operacionale dhe ato Shqiponja të DVP Berat dhe drejtuesit e lartë të Drejtorisë Vendore të Policisë Berat. Njëkohësisht është ngritur edhe grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë dhe në ndihmë të DVP Berat kanë ardhur grupe të Forcës Kombëtare të Sigurisë Fier.

Shërbimet e Policisë janë vënë në ndjekje të autorëve, duke ngritur postbllokje të shumta në qytetet Berat, Kuçovë, Lushnjë e Fier. Dyshohet se autorët janë nga qarku Fier dhe për këtë arsye janë angazhuar në veprimeve operacionale dhe shërbimet e Drejtorisë Vendore të Policisë Fier dhe Komisariateve në varësi të saj.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 20:05

Atentati në Berat, Report Tv sjell videon e mjetit të shkrumbuar të autorëve

Report Tv sjell videon e mjetit të djegur të autorëve të atentatit në Berat.

Pasi qëlluan në drejtim të 46-vjeçarit Altin Halli në fshatin Dushnik, autorët janë larguar në drejtim të fshatit Kozare ku edhe kanë djegur mjetin.

Policia po punon për arrestimin e tyre.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 19:01

I shpëtoi atentatit sot në Dushnik të Beratit, kush është Altin Halili? I dënuar për vrasje, në 2010 u lirua nga burgu

Altin Halili, 46 vjeçari që i shpëtoi atentatit sot në Berat, është një emër i njohur për drejtësinë. Ai ka qenë i dënuar më parë për vrasje.

Për këtë edhe ka vuajtur dënimin prej 15 vitesh me burg prej të cilit ka dalë në vitin 2010.

Halili ka vrarë Sokol Kaloshin në fshatin Rremas të Lushnjës.

Në fshatin Dushnik pasditen e sotme u qëllua me armë ndaj Altin Halilit i cili po udhëtonte me automjetin e tij.

Më pas u gjet një automjet i djegur në fshatin Kozare të Beratit, që dyshohet se u përdor nga autorët për atentatin e dështuar ndaj Halilit.

G.K/Shqiptarja.com

Share

SI.E./E.H/Shqiptarja.com

TAG: Berat atentat altin halili

Komento

Komente

Ska me profesionistë: 26/08/2024 19:17
Sherjester e kollaqe , gynah qe shpetoj

Përgjigju

Berat: 26/08/2024 19:22
Do jet muabet I fresket ky, sdo ket lidhje me vrasjen ne lushnje

XXX: 26/08/2024 18:17
Ta kishin qënuar do kishin bër mirë

Përgjigju

Ndalohet riprodhimi i kësij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH

Sondazhi i ditës:
Diplomacia, a ka ndryshuar imazhi i Shqipërisë në arenën ndërkombëtare?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

VIDEO/ Shoferi i 'Mercedes'-it parakalon gabim 'Toyota'-n dhe e hedh në kanal, nuk ka të lënduar! Shoqërohet shoferi i dyshuar, do i bëhet dhe test alkooli
25 Gusht, 17:32

Skrapar/ Pas dehjes në lokal 2 vëllezërit rrihen mes tyre dhe gënjejnë Policinë gjatë shoqërimit, merren nën akuzë (EMRAT)
25 Gusht, 12:17

Berat/ Zjarr në fshatin Malinat, digjen 2 ha bimësi dhe dru frutor! Ndërhyrja për shuarjen e flakëve me mjete rrethanore
24 Gusht, 16:46

VIDEOLAJM/ Erdhi Baba Tomorri, erdhi në shtëpinë e tij', flir Meta e 'kalf' në malin e Tomorrit
23 Gusht, 10:32

Bektashinjtë kremtojnë ditën e Abaz Aliut në malin e Tomorrit
22 Gusht, 12:01

Mbahet në Dimal festa traditë e rakisë, verës e rrushit! Prodhuesit ekspozojnë variatetet

Mimoza Sinanaj
20 Gusht, 17:25

Dimal/ Zjarr në fshatin Drenovicë, flakët favorizohen nga era! Dyshohet se është i qëllimshëm

Mimoza Sinanaj
18 Gusht, 18:51

VIDEOLAJM/ Ilir Meta hidhet nga shkëmbi, pas akuzave se i kanë bllokuar llogaritë
17 Gusht, 19:39

Nis nesër pelegrinazhi në Malin e Tomorrit, para se të niseni njihuni me masat e policisë

Mimoza Sinanaj
17 Gusht, 11:08

Po digjëte mbeturinat në tokën e tij dhe shkrumboi plantacioninë me 600 rrënjë ullinj të banorëve, arrestohet 24-vjeçari në Dimal (Emri)
16 Gusht, 14:22

Video/ Dita e pestë e zjarrit në majën e malit të Tomorit, avioni rumun hedh tonelata uji nga ajri në vatrën më aktive
16 Gusht, 12:27

Digjet prej disa ditësh Parku Kombëtar i Tomorrit, nis ndërhyrja me avionin rumun për shuarjen e flakëve! Video e aksionit nga ajri
16 Gusht, 09:57

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i pasaktësuar i kësaj faqeje